

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PAKR 1047 / 12

Data: 13 gusht 2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Tore Thomassen, kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues dhe nga anëtarët e kolegjit – gjyqtarja e EULEX-it Annemarie Meister dhe gjyqtari Abdullah Ahmeti, në pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it Anna Malmström, si procesmbajtëse,

Në procedurën penale kundër të pandehurve:

D I, i lindur më XX.XX.19XX në , nga prindërit S1 dhe S2, me mbiemër të vajzërisë B1, shtetas i Kosovës, me shkollim të mesëm, i pamartuar, me profesion , në paraburgim nga data 17.12.2010;

Në shkallën e parë i liruar nga vepra penale *Vrasje e rëndë në tentativë* sipas neneve 147, pikës 4 dhe 9, lidhur me nenet 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK, në fuqi deri më 01.01.2013) ndërsa i shpallur fajtor për veprën penale *Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm* sipas nenit 291, par. 1 dhe 3 të KPK-së përmes aktgjykimit nr. P 329/11 të datës 29.03.2012 të Gjykatës së Qarkut të Pejës (më tej në tekst aktgjykimit të kundërshtuar) dhe i dënuar me burgim prej 5 (pesë) vjetësh dhe i urdhëruar të paguajë shpenzimet e procedurës penale në vlerën prej 500,00 EUR dhe të shumësh paushalle prej 100,00 EUR si dhe;

B K, i lindur më XX.XX.19XX në fshatin , komuna e , nga prindërit N dhe H, me mbiemrin e vajzërisë B2, shtetas i Kosovës, i martuar, me gjendje mesatare financiare, i papunë, në paraburgim prej datës 17.12.2010 deri më 29.03.2012;

Në shkallën e parë i liruar nga vepra penale *Vrasje në tentativë* sipas nenit 146 lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPK-së dhe *Vrasje e rëndë në tentativë* sipas neneve 147, pikës 4 dhe 9, lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPK-së përmes aktgjykimit të kundërshtuar;

Duke vepruar sipas ankesës së avokatit mbrojtës Gëzim Baloku të parashtruar në emër të të pandehurit D I më 01.06.2012 dhe ankesës së prokurorit të prokurorisë së qarkut të Pejës më 12.06.2012, të dyja këto ankesa ndaj aktgjykimit të kundërshtuar;

Pas shqyrtimit të përgjigjes së prokurorit të apelit të shtetit të Kosovës nr. AP - KZ 313/12 të datës 21.01.2013, të parashtruar të njëjtën ditë;

Pas mbajtjes së seancës publike më 13.08.2013 në praninë e të akuzuare, të avokatëve mbrojtës Gëzim Baloku dhe Ragip Radoniqi dhe të prokurorit të shtetit Lulzim Sylejmani;

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 13.08.2013,

Sipas neneve 420 dhe atyre në vazhdim të Kodit të procedurës penale të Kosovës (KPPK) sjell këtë:

A K T G J Y K I M

I. Ankesa e avokatit mbrojtës Gëzim Baloku e parashtruar në emër të **D I më datën 16.01.2012 ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës nr. P 329/11 të datës 29.03.2012, pranohet pjesërisht.**

II. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Pejës nr. P. 329 / 11, i datës 29.03.2012 NDRYSHOHET lidhur me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit si vijon:

I pandehuri **D I** (i lindur më **XX.XX.19XX**), i shpallur fajtor për *Shkaktim të rrezikut të përgjithshëm në vendin ku ish-in tubuar një numër i madh njerëzish sipas nenit 291, par. 1 dhe 3 të KPK-së, dënohet me burgim prej 4 (katër) vjetësh. Koha e kaluar në paraburgim nga data 17.12.2010 do t'i llogaritet në dënim.*

Arsyet e tjera të ankesës së mbrojtjes refuzohen si të pabazuara.

III. Ankesa e prokurorit të prokurorisë së qarkut të Pejës e parashtruar më 12.06.2012 refuzohet si e pabazuar.

IV. Pjesa tjetër e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës nr. P 329/11 të datës 29.03.2012 vërtetohet.

ARSYETIMI

I. Procedura e gjertanishme në këtë lëndë

1. Më 9 qershor 2011, prokurori publik i qarkut i EULEX-it ka ngritur aktakuzën PP nr. 217/10 ndaj të pandehurve **I I**, **D I** dhe **B K** duke i akuzuar të njëjtit me veprat penale *Vrasje në tentativë* në kundërshtim me nenin 146, lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPK-së (vetëm **D I** dhe **B K**) ndërsa me *Vrasje të rëndë në tentativë* në kundërshtim me nenin 147, pikat 4 dhe 9, lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së të tre të pandehurit. Kjo aktakuzë është konfirmuar me aktvendimin KA. Nr. 211/11 më 26 korrik 2011.

2. Shqyrtimi gjyqësor ka nisur më 5 dhjetor 2011 para trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të përbërë prej dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtar kosovar. Edhe tetë seanca të tjera

gjqësore janë mbajtur më datat 6, 7 dhe 8 dhjetor 2011, më 17 dhe 18 janar 2012 dhe më 13, 20, dhe 28 mars 2012.

3. Gjykata ka dëgjuar dëshmitë e këtyre dëshmitarëve: të palëve të dëmtuara **V Z** dhe **A Z**; **R S**, **M G**, **A N**, **A G**, **H G**, **F C**, **V T**, **M I**, **S I**, **A S**, **B F**, **S H**, **Z L**, **N G** dhe **K B** si dhe ka marrë në pyetje të pandehurit **I I**, **D I** dhe **B K**.

4. Më 29 mars 2012, trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut të Pejës ka shpallur aktgjykimin dhe ka shpallur të pandehurin **D I** të pafajshëm për Vrasje në tentativë si në pikën e parë por fajtor për Shkaktim të rrezikut të përgjithshëm në vendin ku është grumbulluar një numër i madh njerëzish sipas nenit 291, par. 1 dhe 3 të KPK-së, duke bërë kështu rikualifikimin e akuzës fillestare të Vrasjes në tentativë. **B K** është shpallur i pafajshëm për pikën 1, Vrasje në tentativë. Më tej gjykata ka shpallur të tre të pandehurit të pafajshëm për pikën 2, Vrasje e rëndë në tentativë.

5. Më 1 qershor 2012 është ushtruar ankesë me kohë nga avokati mbrojtës Gëzim Baloku në emër të **D I** ndërsa më 12 qershor 2012 brenda afatit kohor ankesë ka parashtruar edhe Prokuroria e Qarkut të Pejës. Nuk është dhënë asnjë përgjigje në këto ankesa. Mendimi i prokurorit të shtetit është parashtruar më 21 janar 2013.

6. Më 1 janar 2013, lënda është kaluar nga Gjykata Supreme e Kosovës si gjykatë kompetente e shkallës së dytë, në Gjykatën e Apelit sipas nenit 39, par. (1) të Ligjit mbi gjykatat, Ligjit nr. 03/L-199.

II. Parashtruesat e palëve

1. Ankesa e avokatit mbrojtës Gëzim Baloku

7. Avokati mbrojtës Gëzim Baloku në emër të **D I** kundërshton aktgjykimin për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin dhe propozon që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar në atë mënyrë që të lirojë **D I** nga vepra e ri kualifikuar penale ose duke e shqiptuar një dënim shumë më të butë ndaj tij.

8. Avokati mbrojtës argumenton se trupi gjykues gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka shpallur fajtor **D I** pasi që nuk është paraqitur asnjë provë e cila do të dëshmonte veprën në fjalë. Nga provat e paraqitura, është vërtetuar se i pandehuri dhe pala e dëmtuar kishin pasur konflikte të mëparshme, se kishte pasur një përplasje midis tyre në parkingun e Vetëshërbimit dhe se gjatë përleshjes ishin dëgjuar dy apo tri të shtëna nga arma. Si rezultat i zjarrit të hapur nga arma, **D I** ishte plagosur në qafë dhe ishte futur në makinë e kishte shkuar në spital. Kjo është gjendja faktike e cila është vërtetuar nga dëshmitarët. Janë gjetur tri gëzhoja të plumbave, njëra 7.65 mm

e revoles që i takonte **V Z**, tjetra 9 mm e revoles që thuhet se i përkiste **D I** por e cila nuk ishte gjetur.

9. Edhe nëse vërtet ka qëlluar nga revolja e vet pasi ishte plagosur është e qartë se kishte vepruar në vetëmbrojtje të nevojshme.

10. Më tutje avokati mbrojtës argumenton se elementi kyç i krimit shkaktim i rrezikut të përgjithshëm sipas nenit 291, par. 1 dhe 3 i KPK-së është se ishte grumbulluar një numër i madh njerëzish në vendin ku ishte shkaktuar kjo vepër penale. Me këtë rast, trupi gjykues ka shkelur ligjin penal kur ka konstatuar se kishte pasur një numër të madh njerëzish për shkak se në të vërtetë në atë rast nuk ishte askush.

11. Përkitazi me vendimin mbi dënimin, trupi gjykues ka qenë shumë i ashpër kur ka shqiptuar dënimin maksimal. Kolegji nuk ka marrë parasysh asnjë rrethanë lehtësuese përkatësisht ato rrethana në të cilat është kryer vepra penale në fjalë. Edhe në qoftë se **D I** vërtet ka shtënë me armë, një gjë të tillë e ka bërë në mënyrë instiktive pasi që ka qenë i plagosur në qafë. Për më tepër, nuk ka pasur motiv për veprën penale dhe se **D I** nuk ka rrezikuar asnjë njeri. Po ashtu, duhet të merret parasysh edhe sjellja e tij e mirë në gjykatë dhe fakti se nuk kishte qenë i dënuar më parë për një vepër të tillë penale.

12. Në seancën e datës 13 gusht 2013 i pyetur nga kryetari i kolegjit, **D I** kishte thënë se plaga e pësuar më 23 shtator 2009 i kishte shkaktuar humbje të pjesshme të të dëgjuarit në njërin vesh si dhe probleme në shtyllën kurrizore për të cilat ai ishte duke u trajtuar.

2. Ankesa e prokurorit të qarkut

13. Prokurori i qarkut e kundërshton aktgjykimin në pjesën që ka të bëjë me shfajësimin e të pandehurve **D I** dhe **B K** nga akuzat e Vrasjes së rëndë në tentativë të kryer në bashkëkryerje sipas pikës 2 të aktakuzës. Arsyet e ankesës janë vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike në bazë të nenit 402, par. 1, pikës 3 të KPPK-së, prandaj prokurori i qarkut propozon që Gjykata e Apelit të anulojë aktgjykimin e kundërshtuar përkitazi me shfajësimin e të pandehurve **D I** dhe **B K** për pikën 2 të aktakuzës dhe ta kthejë lëndën në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

14. Prokurori i qarkut argumenton se aktgjykimi i kontestuar përmban lëshime ngase trupi gjykues nuk ka marrë parasysh çështjet kulturore të cilat mbizotërojnë në Kosovë si dhe rrethanat specifike të cilat kanë rëndësi për analizën e fakteve të vërtetuara. Trupi gjykues më tej nuk ka marrë parasysh reputacionin të cilën **B K** e kishte në regjionin e Pejës në kohën e kësaj ngjarje. Njerëzia në anën e Pejës e dinë shumë mirë se **B K** ka qenë i dënuar edhe më herët dhe në këtë mënyrë kanë fituar bindjen se **B K** dhe shokët e tij janë një grup jashtëzakonisht i dhunshëm dhe

i pamëshirshëm, ndaj të cilit as policia madje nuk ka guxuar të ndërmerre veprimet e duhura. Duke pasur parasysh të gjitha këto, është perceptim i përgjithshëm në atë rajon se çfarëdo dëshmie me të cilën do të akuzohej **B K** do t'i hapte rrugë hakmarrjes së rëndë e cila do të rrezikonte jetën dhe sigurinë e personit i cili dëshmon dhe / apo familjes së tij duke parandaluar në këtë mënyrë palët e dëmtuara që të mos japin dëshmi të vërteta kundër **B K** dhe / apo kundër shokëve të tij.

15. Prokurori i qarkut më tej pohon se vlerësimi i trupit gjykues i cili i është bërë deklaratës së dhënë nga **V Z** ka lëshime pasi që është konstatuar se nuk përputhet me deklaratën e të birit të tij në pjesën e cila ka të bëjë me dritën brenda makinës së sulmuesve, nëse e njëjta ka qenë e ndezur apo jo. Kolegji ka vërejtur se **V Z** ishte duke e mbrojtur të birin duke e shtypur poshtë në çastin kritik që do të thotë se i njëjti ishte në pozitë të tillë sa që nuk mund të shihte asgjë. Lidhur me këtë, prokurori vëren se ndezja e dritës së brendshme në makinën e sulmuesve kishte kuptim pasi që vepra në fjalë ishte kryer në shenjë hakmarrjeje ndaj lëndimit të cilin **V Z** ia kishte shkaktuar **D I**. Gjatë hakmarrjes, kënaqësia e perceptuar e marrjes së hakut do të ishte më e madhe nëse viktima në çastin e kryerjes së hakmarrjes arrin ta njohë sulmuesin.

3. Përgjigjja e prokurorit të apelit të shtetit

16. Prokurori i shtetit i propozon Gjykatës së Apelit të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut ndaj të pandehurve **D I** dhe **B K** sa i përket pikës 2 të aktakuzës dhe të njëjtit të dënohen për vrasje të rëndë në tentativë si edhe të refuzohet ankesa e avokatit mbrojtës si e pabazuar.

17. Lidhur me ankesën e avokatit mbrojtës prokurori i shtetit pohon se doemos duhet të konsiderohet se është provuar se **D I** ka shkrepur – pa marrë në shenjë ndonjë shënjestër të caktuar – dy të shtëna nga arma në një vend publik në afërsi të vetëshërbimit gjatë orarit të rregullt të punës. Kjo gjë provon akuzën e shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm. Prokurori i shtetit është i mendimit se trupi gjykues ka vlerësuar drejt se elementet e veprës penale janë ricilësuar. Prokurori i shtetit ia lë Gjykatës së Apelit vlerësimin nëse dënimi i shqiptuar ka qenë i përshtatshëm apo jo. Megjithatë, prokurori i shtetit konstaton se është e padrejtë dhe e pavërtetuar të konsiderohet statusi i papunë i të pandehurit si një faktor rëndues i cili e bën “të pandehurin të prirë për mosrespektim të urdhrave gjyqësorë në të ardhmen”.

18. Lidhur me ankesën e prokurorit të qarkut, prokurori i shtetit pajtohet me argumentet e sjella nga prokurori i qarkut dhe paraqet se është i nevojshëm rivlerësimi i provave të paraqitura në gjykim para se të vendoset përtej dyshimit të arsyeshëm në të mirë të të pandehurve **D I** dhe **B K**.

III. Gjetjet e Gjykatës së Apelit

1. Kompetenca e gjykatës së Apelit

19. Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur mbi ankesën sipas nenit 17 dhe nenit 18 të Ligjit mbi gjykatat (Ligji nr. 03/L-199).

20. Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar në përputhshmëri me nenin 19 paragrafi (1) të Ligjit mbi gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhja e lëndëve dhe caktimi i lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053).

2. Ligji procedural i aplikueshëm - *mutatis mutandis* Kodi i procedurës penale të Kosovës në fuqi deri më 31.12.2012

21. Ligji procedural penal i aplikueshëm në lëndën penale përkatëse është Kodi (i vjetër) i procedurës penale të Kosovës që ishte në fuqi deri më 31 dhjetor 2012.¹ Interpretimi i duhur i dispozitave kalimtare të Kodit (të ri) të procedurës penale, i cili është në fuqi që nga 1 janar 2013, parashikon që në procedurën penale të iniciuar para hyrjes në fuqi të kodit të ri, e për të cilën gjykimi tanimë ka filluar por nuk ka përfunduar me vendim të formës së prerë, do të aplikohen dispozitat e KPPK-së *mutatis mutandis* derisa vendimi të marrë formën e prerë. Në këtë aspekt përmendet Mendimi ligjor nr. 56/2013 i Gjykatës Supreme të Kosovës, i miratuar në seancën e saj të përgjithshme më 23 janar 2013.

3. Gjetjet mbi meritat

3.1. Ankesa e mbrojtjes

3.1.1. Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike

22. Ankesa e avokatit mbrojtës ankimon aktgjykimin e kundërshtuar për pikën 1 të aktakuzës. Gjykata e Apelit pajtohet me gjendjen faktike të vërtetuar nga trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut. Gjykata konsideron se është provuar se më 23 shtator 2009 **D I** së bashku me, së paku, një mashkull tjetër, takoi **V Z** në parkingun e vetëshërbimit , në një fshat të . Kur janë afruar në vend parkim dhe **V Z**, **D I** dhe burri tjetër kanë pasur armë në duar. Janë shkrepur tri të shtëna. **V Z** ka shkrepur i pari, duke plagosur **D I** në qafë, dhe pastaj **D I** shkrepur dy të tjerat.

23. Trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut konsideroi se nuk është provuar që **D I** ka dashur ta vras **V Z** dhe rrjedhimisht e ri-kualifikoi krimin. Prokurori i Qarkut nuk ka ankimuar këtë pjesë të aktgjykimit prandaj Gjykata e Apelit duhet t'u përmbahet gjetjeve të Gjykatës së Qarkut në këtë aspekt. Megjithatë çështja e mbrojtjes së nevojshme është ende relevante.

¹ Kodi i procedurës penale të Kosovës, në fuqi prej datës 06.04.2004 deri më 31.12.2012.

24. Sipas nenit 8 të KPK-së, mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zmbrazur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të at qasshëm ndaj vetes ose ndaj një personi tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi. **D I** ka argumentuar se kur ka shkrepur armën, ai ka vepruar në mbrojtje të nevojshme. Gjykata e Apelit konstaton se shkrepja e armës nga **D I** nuk mund të konsiderohet mbrojtje e nevojshme. Edhe pse **V Z** ka shkrepur të shtënë e parë, **D I** dhe burri tjetër iu afruan atij me armë në duar dhe rrjedhimisht çdo rrezik ndaj **D I** ishte provokuar nga vet ai. Gjykata e Apelit konsideron se nuk ka pasur sulm të kundërligjshëm, real dhe të at qasshëm kundër **D I** nga i cili nevojitej të mbrohej. Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit plotësisht pajtohet me gjetjet dhe interpretimin e nenit 8 të bërë nga Gjykata e Qarkut².

3.1.2. Shkelja e ligjit penal

25. Krimi Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm është i rregulluar dhe i përcaktuar me nenin 291 të KPK-së. Sipas paragrafit 3 të të njëjtit nen, rrethanë rënduese e krimit është nëse vepra penale është kryer në vendin ku është grumbulluar numër i madh i njerëzve. Në kod nuk ka përkufizim për numrin e madh të njerëzve. Sipas mendimit të Gjykatës së Apelit përkufizimi se çfarë do të thotë numër i madh i njerëzve, duhet të përcaktohet në secilën lëndë veç e veç.

26. Në këtë lëndë, është provuar mjaftueshëm se incidenti ndodhi në vend parkim përballë një vetëshërbimi gjatë orarit të zakonshëm të punës. Ka qenë pasdite kur shumica e njerëzve ka përfunduar orarin e punës. Dhe kësaj duhet shtuar se atë pasdite ishte festa e Bajramit³. Dëshmitari **M G** ka dëshmuar në mënyrë të besueshme se ka pasur shumë njerëz përreth⁴. Në këtë lëndë, Gjykata e Apelit e konsideron të provuar përtej dyshimit të bazuar se kur ndodhi incidenti një numër i madh i njerëzve ishte i grumbulluar aty. Për më tepër, **D I** ka shkrepur armën e tij verbërisht me rrezik të mundshëm që plumbi të qëlloj drejtpërsëdrejti ose me rikoshet ndonjërin nga të pranishmit. Ky rrezik nuk e ka ndaluar **D I** nga shkrepja e armës së tij duke rezultuar në fund në dashje për të shkaktuar rrezik të përgjithshëm. Prandaj të gjitha elementet e krimit janë vërtetuar.

3.1.3. Vendimi mbi dënimin

27. Kur të vendos për dënimin, trupi gjykues duhet të konsideroj edhe rrethanat rënduese edhe rrethanat lehtësuese sipas nenit 6 të KPK-së. Trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut ka renditur të dy llojet e rrethanave, ato rënduese dhe ato lehtësuese por aktgjykimit i mungon arsyetimi lidhur me atë se, pse është shqiptuar dënimi maksimal kur janë marrë parasysh të gjitha rrethanat.

² Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, f 14, paragrafi i dytë, fjalia e fundit e versionit në gjuhën angleze.

³ Aktgjykimi i GjQ në Pejë, f 12, paragraf i dytë i versionit në gjuhën angleze.

⁴ Deklarata e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor më 6 dhjetor 2011, faqja 12 e versionit në anglisht, e cila konfirmon deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës më 6 tetor 2010.

28. Gjykata e Apelit pajtohet me trupin gjykues se rrethanë rënduese e cila duhet të merret në konsideratë, është përdorimi i shpeshhtë i armëve të zjarrit në Kosovë. Gjykata e Apelit pajtohet se dënimi për këtë lloj krimi duhet të shërbejë si preventivë e përgjithshme për të gjithë kryerësit e mundshëm. Gjithashtu Gjykata e Apelit pajtohet lidhur me atë se, mënyra se si **D I** iu afrua **V Z** me armë në dorë tregon nivelin e respektit të ulët të tij për ligjin. Edhe nëse trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut do të konstatonte se dashja e **D I** për të vrarë **V Z** nuk ishte provuar, ajo që duhet të merret parasysh është se **D I** në mënyrë të qartë, ishte i gatshëm për të përdorur armën e tij, edhe nëse ajo ishte vetëm për ta kërcënuar **V Z**.

29. Gjykata e Apelit plotësisht pajtohet me mendimin e prokurorit të shtetit se është e padrejtë që statusi i papunë i pa verifikuar i **D I**, të konsiderohet një faktor rëndues.

30. Si faktor rënduese, Gjykata e Apelit i konsideron veprimet e **V Z** në kohën e ndodhisë. Ashtu sikurse u përmend më sipër, Gjykata e Apelit nuk konsideroi se **D I** veproi në mbrojtje të nevojshme megjithatë fakti se **V Z** e shkrepri së pari armën, e bën të mundshëm faktin se **D I** me gjasë veproi sipas instinktit kur shkrepri armën e tij. Fakti se **D I** u plagos dhe ende vuan pasojat, konsiderohet po ashtu një faktor lehtësuese.

31. Gjykata e Apelit, sjelljen e duhur të të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e konsideron faktor lehtësuese sikurse argumentohet nga avokati mbrojtës. Sjellja e duhur në gjykatë duhet të konsiderohet normë dhe nuk duhet të rezultojë në dënim të zvogëluar.

32. Bazuar në ri-vlerësimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese, Gjykata e Apelit konsideron se dënimi i shqiptuar prej 5 (pesë) vjet burgim është i lartë. Sipas nenit 64 paragrafi (1) të KPK-së dënimi duhet të jetë në proporcion me veprën, si dhe me sjelljen dhe rrethanat e të pandehurit. Duke qenë të kujdesshëm me nenin 291 paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së për veprën penale të Shkaktim të rrezikut të përgjithshëm në një vend ku është grumbulluar një numër i madh i njerëzve e që parasheh dënimin me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet, Gjykata e Apelit përcakton se dënimi i duhur që duhet të shqiptohet ndaj të akuzuarit në këtë lëndë është 4 (katër) vjet burgim. Gjykata e Apelit konstaton se ky ndëshkim do të arrij qëllimin e dënimit sikurse parashihet me nenin 34 të KPK-së.

33. Prandaj Gjykata e Apelit pranon ankesën e avokatit mbrojtës në pjesën ku ankesa kundërshton dënimin e shqiptuar. Aktgjykimi i kundërshtuar andaj ndryshohet në pjesën e dënimit në atë mënyrë që dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit për kryerjen e veprës penale të *Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm në një vend ku është grumbulluar një numër i madh njerëzish* sipas nenit 291 paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së, është 4 (katër) vjet burgim. Koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet në dënimin e të pandehurit.

34. Ankesa e avokatit mbrojtës refuzohet si e pabazuar për të gjitha arsyet e tjera.

3.2. Ankesa e prokurorisë

35. Ankesa e prokurorit të qarkut ankimon aktgjykimin e kundërshtuar për pikën 2 të aktakuzës. Për këtë pikë, Gjykata e Apelit pajtohet edhe me gjetjet faktike të vërtetuara nga trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut. Gjykata konstaton se është provuar që rreth mesnatës, në natën e 11 qershor 2010 në rrugën nga Peja në Prishtinë, **V Z** ishte duke vozitur bashkë me të birin i cili ishte ulur në ulësen e përparme të udhëtarit. Ata janë sulmuar nga një person apo persona të panjohur të cilët kanë shkrepur disa të shtëna në drejtim të veturës së tyre nga së paku, dy armë. **V Z** dhe djali i tij, që të dy pësuan lëndime.

36. E vetmja provë në këtë lëndë në drejtim të të pandehurve është deklarata e **V Z**. I vetmi dëshmitar tjetër i ngjarjes ishte i biri i **V Z** dhe ai nuk ka pohuar t'i ketë parë të pandehurit. Prokurori i Qarkut pohon se Gjykata e Qarkut nuk ka marrë në konsideratë reputacionin që **B K** kishte në rajonin e Pejës në kohën e ngjarjes e edhe efektin që kjo kishte në palën e dëmtuar në kohën kur kjo e fundit ka dhënë deklaratat. Gjykata e Apelit është e vetëdijshme në atë se nëse fama e dikujt i pengon dëshmitarët për të thënë të vërtetën, atëherë kjo është çështje serioze, megjithatë, askush nuk mund të dënohet vetëm thjesht për shkak të reputacionit. Pas shqyrtimit të deklaratave të **V Z** dhe rrethanave të lëndës si edhe ngjarjeve të cilat kanë quar tek incidenti, Gjykata e Apelit konsideron se deklarata e **V Z** nuk është e mjaftueshme për ta konstatuar të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **D I** dhe **B K** kanë kryer krimin për të cilin ata akuzohen. Faktori vendimtar për ta përcaktuar këtë, nuk është fakti se **V Z** ka ndryshuar dëshminë e tij lidhur me pjesëmarrjen e **B K** në ngjarje. Ky është një shqyrtim i tërësishëm i të gjitha provave.

37. Për këtë arsye, Gjykata e Apelit konstaton se ankesa e prokurorit të qarkut është e pabazuar. Prandaj u vendos si në dispozitiv.

Kryetari i kolegjit

Tore Thomassen

gjyqtar i EULEX-it

Anëtarja e kolegjit

Anëtari i kolegjit

Procesmbajtësja

Annemarie Meister
gjyqtare e EULEX-it

Abdullah Ahmeti
gjyqtar

Anna Malmström
zyrtare ligjore e EULEX-it

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë a autorizuar. Aktgjykimi i arsyetuar është përfunduar dhe nënshkruar në shtator 2013.